

Shtojca 20

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik x

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

IN PRINT SHPK

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L92713601Q

Nuis/Nipt

Lagjja 18 Shtatori, Rr. Xheorge Sorros , Gjirokaster

Adresa

Gjirokaster

SHQIPERI

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

068 20 66 664

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@inprint.al

E-mail

Edmond Kushi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2023/06/06

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

068 20 66 664

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. **Numri i referencës së procedurës/Lotit**

Nr. reference: REF-71290-06-01-2023

2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

Procedurë e hapur <input type="checkbox"/>	Procedurë e hapur e thjeshtuar X
Procedurë e kufizuar <input type="checkbox"/>	Procedurë konkurruese me negociim <input type="checkbox"/>
Partneritet për inovacion <input type="checkbox"/>	Dialog konkurrues <input type="checkbox"/>
Procedurë me negociim me shpallje parapraketënjoftimit <input type="checkbox"/>	Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës <input type="checkbox"/>
Shërbim Konsulence <input type="checkbox"/>	
Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP <input type="checkbox"/>	

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Bashkia Gjirokaster

4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

2.433.297,00

5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuader).

Shërbim printimi

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

(Data (viti/muaji/dita)

12.6.2023 10:00

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit
(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)
2.6.2023 10:00

8. Data e nënshkrimit të kontratës
(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavarshmëri të kontratës)

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)
Ligji nr 162 date 23.12.2020 për Prokurimin Publik
Vkm nr 285 date 19.05.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

X

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavarshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavarshmëri)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

Me date 02.06.2023 AK Bashkia Gjirokaster ka hapur proceduren me objekt "Sherbimit te Printimit" me me fond limit: 2.433.297,00 me nr reference REF-71290-06-01-2023

Shoqeria In print ka interes ne kete procedure dhe nuk eshte dakort me kriteret per kualifikim te vendosura ne kete procedure.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

1. Shoqeria In print shpk nuk eshte dakort me piken 2.2.2 (kapaciteti ekonomik dhe financiar) :

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", te ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

- a) Shoqeria In Print shpk nuk eshte dakort me piken 2.2.2 (kapaciteti ekonomik dhe financiar) me paraqitjen e e 3 bilanceve 2020, 2021, 2022 pasi vete fryma e ligjvenesit per kete procedure prokurimi eshte qe autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kjo eshte e percaktuar sakte dhe vkm nr 285 date 19.05.2021 "Per rregullat e prokurimit publik " ku shprehet ne nenin 55:

1. Procedura e hapur e thjeshtuar është një procedurë me një fazë, që mund përdoret nga autoriteti kontraktor për kontrata nën kufirin e ulët monetar, sipas parashikimit në nenin 49, të LPP-së.
2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Çdo operator ekonomik i interesuar mund të paraqesë një ofertë në këtë procedurë.
3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 49, të LPP-së.
4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve:

- i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit¹ që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

¹Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Ne nenin 4 te pikes 55 ligjvenesit shprehet qarte qe per “në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.”

Pra është mese e majftueshme që në këtë procedure prokurimi të thjeshtë për plotësimin e kërkesave financiare të mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

- b) Sipas ligjit financiar afati i fundit për paraqitjen e bilanceve për vitin 2022 është 31.07.2023. Kjo për arsye të verifikimit të bilanceve dhe dokumentave të tjera financiare nga administrata tatimore.

Pra edhe sikur bilanci të jetë i dorëzuar brenda 31.03.2023, për ta terhequr bilancin e vitit 2022 me firmë dhe vule të autoriteteve tatimore është e pamundur pasi akoma pasqyrat financiare janë objekt kontrolli nga administrata tatimore dhe është e pamundur terheqja e bilancit një kohë kaq të shkurter.

Prandaj në lidhje me sqarimet e mesipërme shoqëria in print shpik kërkon:

Heqjen e pikës 2.2.2 nga dokumentat e tenderit, si pikë e ekzagjeruar.

Ose

Heqjen e kërkesës së paraqitjes së bilancit tatimor të vitit 2022, pasi sipas ligjeve financiar afati i fundit për dorëzimin e tij është 31.07.2023.

2.

Shoqëria In Print shpik nuk është dakort me pikën 2.7: **2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë minimalisht 2 persona të cilët duhet të jenë në listëpagesat e muajit Shkurt 2023 – Prill 2023.**

Procedura “Shërbim Printimi” është një procedure ku përveç implementimit të pajisjeve OE do të duhet të shërbejnë dhe mirembajnë pajisjet e printimit përgjate gjithë afatit të kontratës. Nisur nga kjo gjykojmë që minimalisht 1 punonjës të ketë certifikim minimal për mirembajtjen e pajisjeve nga prodhuesi i pajisjeve, distributorët e autorizuar ose shkollat e akredituara.

Komisini i Prokurimit Publik ne vendimin nr.1280/2022, dt:22.12.2022 shprehet se:

“...AK eshte organi pergjegjes per proceduren e prokurimit dhe eshte pergjegjesi e tij te percaktoje kriteret qe jane ne fuksion te realizimit me sukses te kontrates.Kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne AK per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te OE, te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, paisje dhe asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne fuksion te realizimit me sukses te kontrates. Bazuar ne ligjin dhe rregullat e Prokurimit Publik eshte ne te drejten e AK te percaktoje kriteret ne kualifikim ne perputhje me dispozitat ligjore gjithnje kur ato jane te evojshme dhe te lidhura ngushte me objektin e prokurimit, bazuar ne legjislacionin e Prokurimit Publik duke mos i tejkaluar kufijte maksimal te percaktuar ne kete te fundit ne fuksion te qellimit dhe parimeve te ligjit per Prokurimin Publik.

Ne rastin konkret Komisioni konstaton se referuar ankeses se OE si dhe nga shqyrtimi i termave te references dhe specifikimeve teknike Komisioni gjykon,... kerkesa per disponimin e 1 inxhinieri te certifikuar nuk eshte kerkese e ekzagjeruar por i certifikuar nga prodhuesi eshte kerkese kufizuese dhe me synim nxitjen e konkurences dhe sigurimin e nje trajtimi te barabarte dhe jo diskriminues per te gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës ne Procedurat e Prokurimit prandaj AK duhet te marre masa per modifikimin e ketij kriteri duke vendosur togefjaleshin “Ekuivalente” per certifikime ekuivalente....”

Kriterin *“Per te pasur staf teknik te certifikuar per mirembajtjen e paisjeve ”* Komisioni i Prokurimit Publik e ka mbeshtetur dhe me vendimin nr.06/2023 dt: 06.01.2023, pika III.3.3 ku shprehet *“...Komisioni ... konsideron kriter minimal te cilat nuk do te rendonin pozitat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës ne keto lloj procedure...”*

Kerkojme qe pika 2.7 te behet:

*2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë **minimalisht 2 persona** të cilët duhet të jenë në listëpagesat e muajit Shkurt 2023 – Prill 2023.*

1 person te jete trajnuar nga prodhuesi i pajisjes qe posedon OE ose ekuivalent (certifikatat ekuivalente te jene te dhena nga distributori zyrtar ose nga shkolla te akredituara).

Te paraqiten te dhena adrese, tel, email, te personave te kontaktit per verifikim e certifikatave.

Kërkojme pranimin e kërkesave tona.

5. Kërkesë për ekspertizë të posacme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

7. Lista e informacionit konfidencial:

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail: info@inprint.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/ Përfaqësuesi i autorizuar

Edmond Kushi

